



UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës

Nr. 02-55/16-07

Prishtinë, më 28 dhe 29 qershor 2007

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 76 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 21 qershorit 2007,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Debat për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë, sipas kërkesës së Grupi Parlamentar të LDK-së,
4. Debat për Rininë në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së,
5. Debat për zbatim të Rekomandimeve të Kuvendit dt. 7 korrik 2005 për çështjen e pensionistëve në Kosovë,
6. Debat për ndërtimin ilegal të banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në lagjet veriore të Mitrovicës, sipas kërkesës së Grupi Parlamentar të LDD-së,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimit hapësinor dhe
9. Shytimi i Rekomandimeve të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me dhënien e licencës për hulumtime të minerare kompanisë "Kosova Resorce Company L.L.C."

Në fillim të seancës, kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës së Kuvendit, e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Në ndërkokë, Komisioni për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor kishte kërkuar që pika e shtatë: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje të shtyhet për seancën tjetër të radhës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e këtij komisioni. Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që Projektligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje të shtyhet për seancën tjetër të radhës.

Grupi parlamentar i AAK-së kishte kërkuar që pika e gjashtë: Debat për ndërtimin ilegal të banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në lagjet veriore të Mitrovicës të shtyhet për një seancë tjetër të radhës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e këtij grupi. Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që debati për ndërtimin ilegal të banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në lagjet veriore të Mitrovicës të shtyhet për një seancë tjetër të radhës.

Jakup Krasniqi, në emër të grupeve Parlamentare të PDK-së, tha se kërkesat e grupeve parlamentare përfshijnë debatuar përfshiktë të caktuara duhen të shqyrtohen me kohë e jo pasi ta humbin aktualitetin.

Ai kërkoi që Kuvendi të deklarohet lidhur me procesin aktual politik që po kalon vendi.

Deputeti Fadil Geci kërkoi që Kuvendi të debatojë përfshirjen e zgjidhjes së statusit politik të Kosovës.

Kryetari tha se kërkesat duhet të parashtronë me shkrim dhe në procedurë të rregullt.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 21 qershorit 2007

Procesverbal i seancës plenare të 21 qershorit 2007 u miratua pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Sala Berisha-Shala i kishte parashtruar pyetje ministrit të Punëve të Brendshme lidhur me veprimet e kësaj ministrie përfshiktë dhënien e dokumenteve në komunën e Drenasit.

Ministri Blerim Kuçi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Zylfiye Hundozi i parashtri pyetje ministrit të Transportit dhe të Postës Telekomunikacionit lidhur me asfaltimin e rrugës Xërxe-Ratkoc-Kramovik.

Ministri Qemajl Ahmeti iu përgjigj pyetjes së deputetit Hundozi.

Deputetja Nait Hasani i parashtri pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit lidhur me veprimet e kësaj ministrie përfshiktë vërtetimin e relikteve të zbuluara nga vërshimet në fshatin Vrellë, komuna e Istogut.

Ministri Astrit Haraqija iu përgjigj pyetjes së deputetit Hasani.

Deputetja Hatixhe Hoxha i parashtri pyetje ministrit të Transportit dhe të Postë Telekomunikacionit lidhur me mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore.

Ministri Qemajl Ahmeti iu përgjigj pyetjes së deputetes Hoxha.

Deputetja Safete Hadërgjonaj i parashtri pyetje ministrit të Transportit dhe të Postë Telekomunikacionit lidhur me mirëmbajtjen e magistrales Prishtinë- Pejë..

Ministri Qemajl Ahmeti iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadërgjonaj.

4

3. Debat për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e micionit ta marrë fjalën.

Alush Gashi, kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, - Që nga viti 1981 në Kosovë nuk është bërë regjistrimi i popullsisë, i ekonomive familjare dhe i banesave. Gjatë 26 vjetëve në Kosovë kanë ndodhur një varg zhvillimesh, dyndje të popullsisë jashtë vendit si pasojë e represionit dhe diskriminimit sistematik të regjimit serb, luftës dhe spastrimit etnik, si dhe lëvizjet nga fshati në qytet. Në mungesë të regjistrimit nuk kemi të dhëna statistikore, të kompletuara ku përfshihen numri i përgjithshëm, struktura dhe shtrija gjeografike, punësimi, bizneset, prona, përdorimi i tokës dhe trendët zhvillimore në aspektin social, kulturor, ekonomik etj. Regjistrimi i popullsisë është prioritet i Kosovës për të pasur një pasqyrë reale të gjendjes demografike në vend, por edhe për të përcaktuar synimet tona sociale, ekonomike dhe zhvillimore në nivel lokal dhe qendror.

Ne e vlerësojmë lartë punën e Ministrisë të Shërbimeve Publike, të Entit të Statistikave të Kosovës, që në bashkëpunim me Konzerciumin Teknik Ndërkombëtar për përgatitjet cilësore për mbajtjen e regjistrimit të përgjithshëm. I inkurajojmë të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e përgatitjeve, që të vazhdohet me seriozitet, në mënyrë që ky regjistrim i përgjithshëm të jetë në harmoni të plotë me standarde ndërkombëtare.

Duke mbështetur punën e Komisionit Qendror për Regjistrim, Entit të Statistikave dhe mekanizmave ndërkombëtarë, që janë duke e ndihmuar përgatitjen e regjistrimit cilësor, në përputhje të plotë në standarde ndërkombëtare, ne jemi kundër politizimit të këtij procesi dhe inkurajojmë të gjithë qytetarët e Kosovës që të marrin pjesë në këtë proces të rëndësishëm përvardin tonë.

Propozimi i Entit të Statistikave të Kosovës për mbajtjen e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave përvjetë të këtij viti është i pranueshëm.

Kuvendi i Kosovës duhet të marrë qëndrim lidhur me mbajtjen e regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave dhe ta përcakton datën e regjistrimit.

Kryetari e ftoi ministren e Shërbimeve Publike ta marrë fjalën.

Ministrja Melihate Tërmkollı, – Projekti i regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë është ndër projektet më të rëndësishme të institucioneve të Kosovës dhe atë së paku për dy aspekte. Së pari, ngase ky projekt realizohet pas 26 vjetësh të cilat në Kosovë karakterizohen me lëvizje shumë dinamike, demografike, ekonomike politike dhe

sociale. Standardet ndërkombëtare kërkojnë që regjistrimi i popullsisë të mbahet çdo 10 vjet. Së dyti, përveç krijimit të bazave të dhëna statistikore, më se e nevojshme për hartimin e politikave zhvillimore në Kosovë, institucionet vendore gjithashtu tregojnë pjekurinë politike që të udhëheqin dhe realizojnë një projekt aq kompleks dhe aq të rëndësishëm për vendin. Regjistrimi i popullsisë, i ekonomive familjare dhe banesave paraqet, po ashtu, edhe realizimin e të drejtës elementare të qytetarëve të Kosovës për të dëshmuar identitetin, pasurinë dhe përkatësinë individuale dhe kolektive të tyre dhe njëkohësisht paraqet detyrimin e institacioneve për të garantuar ruajtjen e fshehtësisë së këtyre të dhënave.

Bazën ligjore për mbajtjen e regjistrimit të popullsisë e paraqet Ligji që e ka miratuar Kuvendi i Kosovës dhe që e ka shpallur PSSP-ja me Rregulloren nr. 2004/53.

Kuvendi i Kosovës, me propozim të Qeverisë, e ka formuar Komisionin Qendror të Regjistrimit të Popullsisë. Janë formuar të gjitha komisionet komunale, përveç në tri komuna që nuk janë ende të kyçura në procesin përgatitjeve të regjistrimit të popullsisë.

Duke qenë pjesë e përgatitjeve për regjistrim të përgjithshëm të popullsisë prej 31 dhjetorit deri më 14 nëntor në Kosovë është mbajtur regjistrimi i parë testues.

Konkluzionet e dala nga regjistrimi i parë testues tregojnë pjesëmarrje të plotë të popullatës, pra të qytetarëve nga të gjitha komunitetet që janë përfshirë në këtë regjistrim. Funksionimi i fushës së hartografisë, respektivisht përdorimi i hartave në terren është treguar shumë i suksesshëm. Më pak të sukseshtme janë treguar fusha e trajnimit dhe fushata senzibilizuese.

Nga 30 tetor deri më 14 nëntor 2006 është mbajtur regjistrimi i dytë testues në tri komuna, Pejë, Kamenicë dhe Shtërpcë. Gjatë regjistrimit testues komisionet komunale në këto komuna kanë qenë shumë funksionale dhe në përputhje me kompetenca dhe detyrat e tyre ligjore. Janë realizuar në tërsi parashikimet që kanë qenë të lidhura me përgatitjet për regjistrimin e popullsisë.

Një moment i ri në përgatitje për regjistrimin e popullsisë është përfshirja e regjistrimit të popullsisë në pakon e presidentit Ahtisari. Edhe përkundër përpjekjeve të institacioneve të Kosovës që mos të politizohet kjo çështje që duhet të ketë karakter zhvillimor edhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, në pakon e z. Ahtisari ky proces ka marrë një dimension politik. Në këtë kontekst Republika e Serbisë dhe shtetet e tjera fqinje do të autorizonë regjistrimin përmes një Agjencie Ndërkombëtare të Refugjatëve dhe Personat e Zhvendosur që dëshirojnë të kthehen në Kosovë.

Më 9 shkurt 2007 u kam dërguar një shkresë Ekipit të Unitetit, Zyrës së UNUSE-kut dhe Qeverisë së Kosovës, ku kam kërkuar që teksti i nenit 14.1 të ndryshohet në formulimin e ri, që në vend -të pas një viti- të thuhet: "brenda një viti".

Ministria e Shërbimeve Publike, Enti Statistikës i Kosovës, zyrat komunale të regjistrimit dhe mekanizmat e tjerë janë të përgatitura në planin teknik dhe profesional që regjistrimi i popullsisë, i ekonomive familjare dhe banesave të mbahet në vjeshtë të këtij viti.

Në bazë të Ligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave Kuvendi i Kosovës në bashkëpunim me PSSP-në duhet ta caktojë datën e mbajtjes së regjistrimit.

Pas fjalës së ministres Tërmkollit, kryetari e hapi debatin.

Në emër të grupeve parlamentare diskutuan: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Fehmi Mujota, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, Nazim Jashari, në emër të Grupit Parlamentar 6 Plus, Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Numan Baliq dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së Ramadan Kelmendi si dhe deputetët: Ali Sadria, Qibrije Hoxha, Ferid Agani, Ibrush Jonuzi, Nexhat Rexha, Bislim Hoti dhe Ymer Halimi, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Ministrja Melihate Tërmkollli iu përgjigj vërejtjeve të deputetëve lidhur me përgatitjet e kësaj ministrie për organizimin e regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë.

Në fund të debatit, në emër të parashtruesit të mocionit, Alush Gashi kërkoi nga kryetari i Kuvendit që, në bashkëpunim me PSSP-në, me Presidentin e Kosovës dhe me Qeverinë e Kosovës, regjistrimi i popullsisë, i ekonomive familjare dhe i banesave në Kosovë të realizohet sa më parë që të jetë e mundshme.

Kryetari dha pauzë për drekë.

4. Debat për Rininë në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e mocionit ta marrë fjalën.

Jakup Krasniqi, kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, - Jemi vendi me popullsi më të re në Evropë. Gjysmën e popullsisë e kemi nën moshën 25 vjeç, vetëm të rinjtë e moshës prej 15 deri 25 vjeçar përbëjnë rrëth 21% të popullsisë. Kjo është sfidë, por mund ta shndërrojmë edhe në shancë dhe perspektivë të madhe për zhvillimin dhe përparimin e vendit tonë.

Jemi të bindur se në Kosovë duhet të ketë një politikë kombëtare për edukimin, për arsimin, për shëndetësinë dhe punësimin e rinas. Gjatë këtyre 8 vjetëve institucionet e Kosovës, si ato vendore e ato ndërkombëtare, kanë bërë tepër pak për të ndryshuar kualitetin e jetës, të mësimit, të edukimit, të studimit, të shëndetit si dhe të punësimit për njeriun tonë të ri. Nuk kemi arritur të krijojmë ambient të sigurt dhe me perspektivë për gjeneratën e re. Përkundrazi, gjenerata e reja perspektivën po e kërkojnë jashtë kufijve tanë. Prandaj, për ta përmirësuar pozitën e rinas sonë, propozojmë këto

R E K O M A N D I M E:

1. Politikën e shkollimit dhe të punësimit të të rinjve, sipas principit të mundësive të barabarta, duhet ta shndërrojmë prioritet kombëtar.
2. Të rriten kapacitet në UP për t'ua mundësuar regjistrimin e të rinjve që dëshirojnë të studiojnë, ngase në Kosovë janë të regjistruar 1440 studentë në 100.000 banorë, kurese në vendet e rajonit situata është shumë më e volitshme.
3. Sistemi i shkollimit dhe i edukimit duhet të jetë në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe harmonizimi i plan-programeve me ato të vendeve të përparuara perëndimore.
4. Nuk duhet të lejojmë që të prodhojmë çdo vit "armatë të papunësh" për të cilët nuk kujdeset askush.

5. Qeveria e Kosovës të hartoje plane për organizimin e kurseve profesionale për te rejat dhe të rinjtë, që e kanë braktisur shkollën, për tu aftësuar për tregun e punës.
6. Të merren masa efektive për zbutjen e papunësisë, si: punësimi sezonal në vendet që kanë nevojë për këtë; punësimi me orar të shkurtuar; organizimi i trajnimeve për profesionet e dyta, etj.
7. Të rinjve që janë të regjistruar në Entitet e Punësimit t'u sigurohet nga Buxheti i Kosovës një ndihmë minimale në shumën prej 50€.
8. Të marren masa institucionale për zgjogëlimin e shkallës së braktisjes së shkollimit fillor dhe të mesëm.
9. Të rritet numri i nxënësve me arsimin profesional. Të inkurajohen dhe të mbështeten të rinjtë nga institucionet shtetërore për të hapur ndërmarrje private.
10. Të rinjtë të përfshihen në institucionet publike shoqërore, si në Kuvend, në Qeveri dhe në parti politike.
11. Ministria e Shëndetësisë dhe të gjitha institucionet e shoqërisë të marrin masa të nevojshme për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse dhe të narkomanisë, përmes programeve informative dhe shpjeguese në shkolla dhe në Universitet.
12. Shteti t'i mbështetë familjet e reja, përmes subvencioneve për kushte banimi, këshilla për nënrat e reja, për menaxhimin e buxhetit familjar, si dhe me kredi preferenciale.

Kryetari e ftoi ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ta marrë fjalën.

Ministri Astrit Haraqija, – Ne, si Ministri, kemi përfunduar hartimin e dy politikave afatmesme të rinisë siç janë: Plani kosovar i veprimit për rini 2007 -2010 dhe Plani aksionar i punësimit të të rinjve për periudhën 2007 -2010. Këto dhe disa politika tjera janë arritur të ndërtohen në bashkëpunim me partnerët e qëndrueshëm dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe institucionet vendore dhe shumë organizata joqeveritare rinore.

Për zhvillimin dhe përkrahjen e rinisë, gjatë vitit 2006, organizatat e ndryshme ndërkombëtare kanë dhënë ndihmë të konsiderueshëm përmes donacioneve. Kështu për shembull: Banka Botërore, OSBE-ja, GTZ-ja, UNDIP-a UNICEF-i dhe IOM-i vitin e kaluar kanë nda donacion në shumën rrëth 1 milion e 279 mijë €.

Edhe gjatë këtij viti, disa organizata ndërkombëtare kanë vazhduar me donacione edhe pse me shkallë pak më të ulët.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, gjatë vitit 2006, për zhvillimin dhe përkrahjen e rinisë dhe mbrojtjen dhe integrimin e saj ka investuar rrëth 400 mijë €. Këto mjete dhe të tjera që u siguruan më vonë janë shfrytëzuar kryesisht për mundësinë, për promovimin dhe zhvillimin e pjesëmarries të të rinjve në jetën aktive shoqërore në Kosovë.

Në epikondër të veprimeve tona kemi pasur edhe rrjetëzimin dhe informacionin publik për sektorin rinor, promovimin rinor, fuqizimin e OJQ-ve rinore, politikat rinore, edukimin joformal, participimin dhe integrimin e rinisë, edukimin shëndetësor dhe pënnësimin e të rinjve.

Rinia jonë sot duhet të jetë e informuar dhe të jetë pjesë aktive politike në vendimmarje, si bartëse kryesore e jetës dhe aktivitetet, duhen të kyçen në projekte të rëndësishme siç ishte ai i vitit të kaluar lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Faza e dytë e këtij projekti ka filluar edhe sivjet, dhe janë organizuar disa takime për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë në disa komuna të Kosovës.

Plani i veprimit për rini në programin e vet përfshinë pjesëmarrjen e të rinjve, arsimimin dhe edukimin, punësimin, shëndetësinë, sigurinë njerëzore si dhe kulturën, sportin dhe rekreacionin. Ky plan ka për qëllim që t'i përfshijë të gjitha organizatat qeveritare dhe joqeveritare në identifikimin dhe përmbrushjen e nevojave të kërkesave të të rinjve.

Ministria në planin e veprimit kundër trafikimit për qenien njerëzore në Kosovë ka pasur për objektiv strategjik parandalimin që përfshinë vetëdijesimin rrëth pasojave të trafikimit, zvogëlimin e rrezikshmërisë ndaj trafikimit, zvogëlimin e kërkesave rrëth trafikimit. Në Shkollën e policisë në Vushtrri është realizuar projekt: Ndal punës së fëmijëve dhe trafikimi. Ky projekt është mundësuar falë ndihmës së punës së fëmijëve, Shërimit Policor të Kosovës dhe Njësitet kundër trafikimit, IOM-it, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe organizatave tjera.

Sfidat me të cilat ballafaqohemi janë: Buxheti është shumë i limituar për rininë; zvogëlimi i donacioneve të huaja; përkrahja e ulët; mungesa e shërbimeve për të rinj, si dhe përvoja e limituar e shoqërisë civile për ofrimin e shërbimeve cilësore për rininë, sidomos për aktivitete të grupeve të marginalizuara.

Me qenë se infrastruktura kulturore, jo vetëm në kryeqytetin e Kosovës, por edhe në gjithë vendin është jo e kënaqshme, ne tashmë kemi shpallur konkursin dhe fituesin e projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë së Operës dhe Baletit me emrin e doktor Ibrahim Rugovës.

Kushtet e mira për arsimimin e të rinjve, po ashtu, edhe minoritar kanë ndryshuar pozitivisht. Qeveria deri në fund të vitit 2006 ka rinouar dhe pajisur me inventar shkollor mbi 15 shkolla dhe të minoriteteve për një shumë rrëth 1 milion €. Ndërsa, shkollat që janë në ndërtim e sipër kapin një sipërfaqe prej 36 mijë metra katrorë, kurse janë rinouar mbi 4700 metra katrorë. Për nevojat e të rinjve që i përkasin botës akademike dhe universitare deri më tash janë investuar 4 milion e 700 mijë €.

Pas fjalës së ministrit Haraqija, kryetari e hapi debatin.

Në emër të grupeve parlamentare diskutuan: Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Gjylshene Berisha, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylne Syla, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar 6 Plus, Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Ferid Agani dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së Ramadan Kelmendi si dhe deputetët: Enver Hoxhaj Ymer Halimi, Sala Ahmeti, Xhelal Canziba, Ragip Zekolli, Remziye Nimani, Drita Statovci, Sanije Aliaj, Naxhije Doçi, Nuran Malta, Hajredin Hyseni, Emrush Xhemajli, Hatixhe Hoxha, Mark Krasniqi, Myrvete Dreshaj – Baliu, Mazlloム Kumnova, Ymer Muhaxheri, Rudina Bukoshi, Zylfije Hundozi dhe Zylfi Merxha, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Ministri Astrit Haraqija iu përgjigji vërejtjeve të deputetëve lidhur me planet dhe veprimet e kësaj ministrie për zgjidhjen e problemeve të rinisë në Kosovë.

Në fund të debatit, në emër të parashtruesit të mocionit, - Jakup Krasniqi,- Ne, në fjalën e Grupit Parlamentar propozuan 12 rekomandime, por mendoj që njëri është kryesori: Hartimi dhe miratimi i një Strategjie Kombëtare për Rininë, për edukimin, për arsimin, për shëndetësinë, për punësimin dhe për krijimin e mundësive të kësaj gjeneratë për të krijuar familje të re.

Ta ngarkojmë Komisionin përkatës Funksional t'i përgatit rekomandimet, mbi bazën e këtij debati që është zhvilluar sot, dhe t'ia paraqes kuvendit për miratim në seancën e radhës.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se e mbështet kërkesën që Komisioni Funksional, në bazë të debatit të zhvilluar në seancën e sotëm, t'i përgatitë Rekomandimet për rininë në Kosovë dhe Kuvendit t'ia paraqesë për miratim në seancën e radhës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën e sotme në orën 17:30 minuta.

E premte, 29qershor 2007

Vazhdim i seancës

Seancën e kryesoi Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Të pranishëm në seancë ishin 65 deputetë.

5. Debat për zbatim të Rekomandimeve të Kuvendit dt. 7 korrik 2005 për çështjen e pensionistëve në Kosovë

Kryesuesi e fttoi përfaqësuesin e mocionit ta marrë fjalën.

Deputetja Fatmire Mulhaxha – Kollçaku tha se Komisioni i Punës, Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,- ka kërkuar që sot të diskutohet lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës të miratuara më 7 korri, sepse ka dy 2 vjet që ato rekomandime Kuvendi i ka miratuar njëzëri, por Qeveria e Kosovës nuk i ka zbatuar. Qeveria e Kosovës, jo vetëm rekomandimet për pensione, por edhe shumë vendime të tjera nuk i ka zbatuar. Duhet të shohim se ku jemi në zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve që i merr ky Kuvend.

Kryesuesi e fttoi përfaqësuesin e Qeverisë ta marrë fjalën.

Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, z. Ibrahim Selmanaj,- Ministria në kuadër të përgjegjësive të veta, të përcaktuar me akte ligjore dhe nënligjore, që nga themelimi i saj prioritet të veçantë ka pasur krijimin e aplikimit të skemave pensionale për kategori të caktuara të qytetarëve të Kosovës. Skemat pensionale të krijuara në periudhën e pasluftës dhe të cilat aktualisht janë të aplikueshme janë të karakterit të përkohshëm duke pasur për qëllim themelor uljen e varfërisë në vendin tonë dhe duke pasur parasysh karakterin e përkohshëm të këtyre skemave, si dhe moskrijimit e sistemit të sigurimit pensional dhe invalidor të detyrueshëm në këto skema. Ministria në vazhdimësi ka insistuar në krijimin e sistemit të qëndrueshëm të sigurimit pensional dhe invalidor.

Ministria ka hartuar draftin fillestar të Projektligjit për sigurimin pensional dhe invalidor dhe e ka dërguar për miratim në Qeveri, por ajo mori vendimin për ta shtyr miratimin e këtij projektligli për shkak të kostos së lartë financiare.

Është bërë kërkesë përsëri që të filloj rishqyrtimi i të njëjtë projektligji, duke pasur parasysh edhe rekomandimet e Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe të Banka Botërore.

Pas vendimit të Qeverisë MPMS ka filluar shqyrtimin e kostos financiare të këtij Projektligji

Pas përfundimit të rivlerësimit të kostos financiare MPMS i ka propozuar Qeverisë së Kosovës që të miratojë Projektligin, por Qeveriapërsëri ka vendos të shtyhet miratimi i këtij Projektligji.

Qeveria e Kosovës ka vundosur ta themelojë një Komision në përbërje të gjerë, të udhëhequr nga zyra ligjore e Kryeministrat, që ta rishqyrtojë në tërësi këtë projektligj në mënyrë që t'i ofrohet Qeverisë së Kosovës një version që zgjedhon ndikimin negativ në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Qeveria e Kosovës çështjen e Fondit Pensional të Kosovës të grabitur nga shteti i Serbisë e ka ngritur disa herë në takime të ndryshme, por ende nuk e kemi marrë një përgjigje të saktë se cili do të jetë pozicioni i Qeverisë së Kosovës në këtë drejtim dhe në një prej rekomandimeve që e kam thënë edhe më herët në bisedimet e Vjenës është kërkuar të bëhen decentralizimi dhe bartja e përgjegjësive nga niveli qendror në nivelin lokal.

Me zgjidhjen e statusit dhe me bartjen e përgjegjësive te Qeveria e Kosovës do të hapet debati që ai Fond t'u kthehet njerëzve që ju takon.

Ne nuk jemi të kënaqur me shumën e cila u dedikohet pensionistëve në Kosovë, mirëpo disa herë është analizuar situata shumë e rëndë e shfrytëzuesve të këtyre pensioneve, të cilët kanë kontribuuar me vite të tëra në Fondin Pensional, por nuk ka ekzistuar një mundësi përritjen e pensioneve dhe rekomandimi në pikën e 5 nuk ka mund të realizohet për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore.

Pas fjalës së ministrit Selmanaj kryetari e hapi debatin.

Në emër të grupeve parlamentare diskutuan: Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naim Jerliu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Zahrije Jusufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Zylfije Hundozi, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, Fatmire Mulhaxha-Kolçaku, në emër të Grupit Parlamentar 6 Plus, Nuran Malta, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Ferid Agani dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së Ramadan Kelmendi si dhe deputetët: Teuta Hadri, Nafije Berisha, Teuta Sahaqija, Mazllom Kumnova, Fetah Berisha, Nekibe Kelmendi, Nazim Jashari, Shaban Halimi, Hydajet Hyseni, Sanije Aliaj, Milazim Haliti, Afrim Arziallaxhiu, Behxhet Brajshori, Gjylaze Syla dhe Ilaz Pireva, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Ministri Ibrahim Selmanaj iu përgjigj vërejtjeve të deputetëve lidhur me rekomandimet e Kuvendit të dt. 7 korrik 2007.

Në fund të debatit, në emër të parashtruesit të mocionit, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku kërkoi që të shikohen përvojat e shteteve në rajon, që e kanë kaluar fazën e transacionit, se si i kanë zgjidhur çështjet e pensioneve.

Në bazë të debatit del që rekomandimet Qeveria duhet ti zbatojë, por si? Së pari, me hartimin e strategjisë për sigurime shoqërore, si parakusht për zbatimin e rekomandimeve. Nën dy, sistemi pensional, që preferohet të jetë i bazuar në krijimin e fondevë publike është parakushti

për amendamentimin ed Ligjit për financat publike, që lidhur me krijimin e fondeve publike dhe tek atëherë sjellja e ligjit në Kuvend.

Prandaj, e vetmja rrugë për ta zgjidhur çështjen e pensioneve është të hartohet një Strategji e qartë nga ana e Qeverisë së Kosovës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimit hapësinor

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor në Projektligjin ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimit hapësinor.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Pastaj, kryesuesi i hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----56;
Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës njëzéri miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimit hapësinor.

7. Shytimi i Rekomandimeve të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me dhënien e licencës për hulumtime të minerare kompanisë “Kosova Resorce Company L.L.C.”

Kryesuesi e ftói përfaqësuesin e komisionit Funksional ta marrë fjalën.

Ibush Jonuzi, kryetar i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, energjetikë, Transport dhe telekomunikacion, - ta se Komisioni, në bazë të përfundimit të seancës plenare të mbajtur më 21 qershor 2007, ka analizuar debatin e zhvilluar për mocionin e ngritur dhe në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare, Kuvendit i propozon këto

R E K O M A N D I M E:

1. Auditori i Përgjithshëm të vlerësojë ligjshmërinë dhe konflikt- interesin, me rastin e dhënies së licencës për hulumtim-eksplorim në lokacionin e Drazhnjes, Kompanisë „Kosovo Resources LLC“ nga KPMM-ja.

Auditori i përgjithshëm obligohet që vlerësimin ta bëjë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të rekomandimit.

-Nëse vërtetohet se ka pasur shkelje të legislacionit në fuqi apo konflikt interes, Kryesia e Kuvendit të Kosovës lëndën t’ia procedojë PSSP-së për anulim.

-Nëse auditori i përgjithshëm brenda afatit të caktuar nuk përfundon me vlerësim, Kryesia e Kuvendit obligohet që kërkesën për anulimin e licencës t’ia dërgojë PSSP-së .

2. PSSP-së ta shpallë Ligjin për miniera dhe minerale i miratuar më 19 janar 2006 dhe Ligjin për hulumtime gjeologjike, të miratuar më 10 tetor 2006, në të kundërtën të arsyetojë mos shpalljen e tyre.
3. Kuvendi i Kosovës me akt juridik resurset natyrore të Kosovës t'i shpallë Pasuri Nacionale dhe të marrë përsipër menaxhimin e tyre.
4. KPMM-ja ta hartojë Planin për menaxhimin e resurseve minerale në Kosovë dhe para se t'ia procedojë për miratim Ministrisë për Energjetikë dhe Miniera, sipas nenit 61 të Rregullores 2005/3 i njëjtë të debatohet në Kuvendin e Kosovës.
5. Qeveria e Kosovës të hartojë politikë të qartë konsensuale, Qeveri –Kuvend për të ardhmen e minierave në Kosovë e në veçanti të minierave të Trepçës .
6. Të intensifikohet bashkëpunimi ndër –institucional i KPMM-së me Ministrinë për Miniera e Minerale, kurse Kuvendi i Kosovës përmes Komisionit Funksional ta mbikëqyrë zbatimin e politikave dhe të planit për menaxhimin dhe shfrytëzimin e mineraleve në Kosovë.

Kryesuesi e hodhi në votim rekomandimet e Komisionit Funksional. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----66;
Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës njëzëri miratoi rekomandimet e Komisionit Funksional të cekura më lart.

Kryesuesi e deklaroi seancën të mbyllur në orën 13: 15 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoï

Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale